


Njësia Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2532 Nr. i faq/Br.str/No.pg 24
Data/Datum/Date 2 / 8 / 2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL
KORRIK 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM.....	14

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2022.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji korrik i vitit 2022, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin korrik, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari Smajl Latifi ka uruar mirëseardhje përmërgimtarët, të cilët gjenden në pushime edhe këtë vit, duke e gjallëruar kështu qytetin edhe më shumë. Komuna e Rahovecit edhe këtë vit është e angazhuar maksimalisht që të krijojë kushte sa më të mira, në mënyrë që mërgimtarët të kënaqen edhe këtë verë. Jemi mobilizuar përmirësimi administrative komunale e që të ketë vendparkime të mjaftueshme përtak, si dhe të organizojmë ngjarje kulturore e takime të përbashkëta përtu mallur, por edhe përtë shkëmbyer ide dhe përvoja për projekte të reja zhvillimore në komunën tonë.

Kryetari ka zhvilluar takim me udhëheqjen e KRU "Gjakova", ku kanë biseduar rreth investimeve në sektorin e ujit të pijshëm dhe dobinë që do të sjellin projektet e përbashkëta në mes të komunës së Rahovecit dhe KRU "Gjakova", rreth bashkërendimit të investimeve në sektorin e ujit të pijshëm si në projektet: Rahovec - Hoçë e Madhe - Zaquisht - Opterushë, projekt i ujit të pijshëm në Senoc dhe në Drenoc.

Gjithashtu, u diskutua edhe përmirësimet në Zonën 3 - Rahovec, vështirësitetë në furnizim të fshatrave Patacan i Poshtëm, Patacan i Epërm, Nashpall, zgjidhjen e problemit me ujë të pijshëm përfshirat Vrajakë dhe Bratatin, si dhe përcaktimin e tjerë me qëllim të zgjerimit të zonës operative të furnizimit me ujë të pijshëm.



Është mbajtur mbledhja e katërt e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në vendin tonë: qentë endacak, rreziku nga zjarret përshtakat e temperaturave të larta, etj.





Me drejtorin e Shërbimeve Publike si dhe me disa nga zyrtarët e Drejtorisë për Bujqësi, kryetari ka përcjellur nga afër procesin e korrije – shirjeve në komunën tonë.

Bujqit e komunës sonë, përkundër kohës së vështirë, të cilët përballen me rritje çmimesh të farërave, karburanteve e preparateve të nevojshme që nga mbjellja e grurit e deri te korria, megjithatë po i mbledhin rezultatet e punës së tyre të palodhshme.

Komuna e Rahovecit është e orientuar qartë dhe me vendosmëri i jep prioritet bujqësisë, prandaj ndihma e komunës për bujquit është gjithmonë e prekshme dhe e pranishme.

Së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me drejtorin e Drejtorisë së Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit, si dhe bashkëpunëtorë të tjera, kryetari ka bërë shpërndarjen e mekanizmave dhe mjeteve bujqësore për 81 bujq.

Në fazën e tretë janë shpëndarë 54 spërkatëse, 2 pajisje për mbjelljen e misrit dhe 25 motokultivatorë me frezë 7.5 KW.




Së bashku me përfaqësuesit e organizatës ndërkontinentale ASB (Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland), kryetari Latifi ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për financimin e dy projekteve të rëndësishme për komunën tonë, ku hyjnë funksionalizimi dhe rregullimi i hapësirës së jashtme të Qendrës për Qëndrim Ditor për të Moshuarit si dhe furnizimi i OJQ-së "Hareja" me pajisje të teknologjisë së informacionit në vlerë prej 10.000 Euro.



Nën organizimin e Shoqërisë "Lëvizja", në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur aktiviteti i manifestimit të 40 vjetorit të bashkimit të organizatave atdhetare.

Te Muri i Pikëllimit në Rahovec, për nder të 17 korrikut të vitit 1998, kryetari Smajl Latifi së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kanë bërë homazhe për martirët dhe dëshmorin e parë të Epopesë së Rahovcit të korrikut 1998, Avdullah Bugari.



Për nder të 17 korrikut 1998, në praninë e bashkëluftëtarëve, familjarëve të dëshmorëve dhe qytetarëve, në kujtim të Epopesë së Rahovcit janë zbuluar edhe pllakat në shtëpitë që kanë qenë baza dhe në shërbim të UÇK-së.





Homazhe janë bërë edhe në Fortesë, ku me 18 korrik të vitit 1998, mes luftimeve të ashpra kundër armiku, ranë në altarin e lirisë heronjtë Agim Kelmendi, Gani Paçarizi dhe Tafil Zyberaj.

Poashtu, në 24-vjetorin e Epopesë së Fortesës, është zbuluar edhe pllaka përkujtimore për ndër të 68 martirëve të fshatit, të cilët u vranë mizorish në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999 nga forcat kriminale serbe.

Homazhet kanë vazduhar edhe me 19 korrik, para lapidarit të dëshmorëve në "Rrugën e UÇK-së", ku janë të skalitur emrat dhe figurat e luftëtarëve trima që u sakrifikuau për lirinë tonë.




Edhe këtë vit kryetari Latifi për ndër të Muajit të Mërgimtarëve, ka hapur dyert e zyrës së tij për takime me bashkëqytetarët tanë që jetojnë në mërgim, e që gjenden në pushime në vendin tonë.



Në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, bashkë me zevendëministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi, është nënshkuar marrëveshje mirëkuptimi përmbështetjen financiare të projektit përasfaltimin e rrugëve në qytet, me vlerë 600,000.00€, si dhe është nënshkuar marrëveshja edhe përfundimin e financimit të projekteve, përrrugët tashmë të përfunduara: Rahovec - Hamoc - Fortesë si dhe Xërxe - Sapniq - Ratkoc.

Së bashku me ish-kryeministrin e Kosovës dhe kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, bashkëluftëtarë, miq e familjar me 21 korrik janë bërë homazhe para shtatores së atdhetarit të madh dhe prijësit fetar nga Rahoveci, heroi Shejh Myhedin Shehu, i cili me 21 korrik 1998, u vra barbarisht nga pushtuesit serbë.



Në kuadër të shënimit të "Epokes së korrikut 1998", me bashkëluftëtarë, bashkpunëtorë dhe familjarë të të rënëve, janë bërë homazhe pranë lapidarit të të rënëve: Arian Brahimi-Shkodrani, Mizahir Isma, Eshrefedin Kastrati, Bekim Isma, Habib Berisha, Ramadan Morina, Ruzhdi Xhuliqi, Samir Nurkasa, Xhafer Nurkasa, Gëzim Mullabazi, Xhevrat Kasapi dhe në kompleksin përkujtimor "Maja e Shkodranit", vendin ku janë gërshetuar madhështia e vlerave dhe sakrifica e Arianit, Mizahirit, Eshrefedinit dhe Bekimit! Gjithashtu, homazhe janë bërë edhe në Bllatë, përnder të dëshmorit të kombit Bajram Veliu.



Së bashku me Drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Republikën e Kosovës, z. Bislim Zogaj, kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit: "Memoriali Masakra e Krushës së Madhe - Krushë e Madhe". Ky projekt kap vlerën 82,504.00€, ku Komuna e Rahovecit merr pjesë me 22,504.50€, ndërsa Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, me 60,000.00€.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, me angazhimin vullnetar të kompanisë EAE-NJAZ, ka bërë eliminimin e deponisë ilegale të mbetjeve inerte në rrugën transite, si dhe në pjesë të tjera të qytetit.




Profesor Dr. Sabahajdin Cena i dhuroi bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" disa ekzemplarë të librit të tij "Kronikë nëpër stuhi". Ku janë të përmbledhura të dhëna jetësore për dëshmorët e kombit të rënë në periudhën janar – mars 1998/99 në luftë për çlirimin e trojeve të pushtuara shqiptare.

Për nder të muajit të mërgimtarëve është organizuar aktiviteti "Ditët e Mërgatës", i cili përfshin aktivitete të ndryshme kulturore, duke filluar me koncertin festiv, ku performoi gruپi i mirënjojur 04 Band.



Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim Dinën, kanë përvuar hapësirën pushuese e rekreative te "Maja e Shkodranit", në kuadër të projektit "Investime në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave", që tashmë kjo hapësirë është gati e do të ofroj një mundësi argëtimi e socializimi për të gjitha moshat, të cilët tashmë kohën e lirë të tyre do të mund ta kalojnë me më shumë lojëra e aktivitete sportive.



Aktiviteti "Ditët e Mërgatës", ka vazhduar me organizimin e koncertit, ku performoi grupi i mirënjojur Fisnikët, të cilët me këngët e tyre i dhanë edhe më tepër emocion dhe gjallëri qytetit.


Kryetari Latifi priti ne takim Lenhard Harnzen nga organizata "Germin", ku bashkëbiseduan rreth mundësive për rritjen e aktiviteteve që fuqizojnë lidhjen e mërgatës me vendin tonë ku në takim u vendos për: vendosjen e hapave për fillimin e kontakteve me komunat e shteteve gjermanofolëse për formalizimin e marrëveshjeve të binjakëzimit, angazhimi afatshkurtër i ekspertëve nga mërgata në fushat prioritare për komunën tone si dhe organizimi i aktivitetit "B2B" ndërmjet ndërmarrësve nga mërgata dhe ndërmarrësve vendorë.





Në 24 vjetorin e rënies së dëshmorëve të atdheut Gëzim Mullabazi, Samir Nurkasa, Xhafer Nurkasa dhe Xhevati Kasapi, e në nderim të kujtimit dhe veprës atdhetare të tyre, Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me OVL të UÇK-së, ka bërë zbulimin e një pllakë përkujtimore në anën e djathtë të rrugës (te vendi i rënies) që çon te "Maja e Shkodranit".


Nën organizimin e Klubit të Shahut "Rahoveci" e në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Federatën e Shahut të Kosovës, si dhe me Komunën e Rahovecit, u mbajt Turneu i parë Ndërkombëtar i Shahut "Korriku 98" në Rahovec, kushtuar Epopesë së Rahovecit në korrikun e vitit 1998 si dhe sakrificës e flijimit të dëshmorëve dhe martirëve që ranë për liri. Në turneun e organizuar kanë marr pjesë 106 garues nga: Kosova, Shqipëria, Finlanda, Austria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.



Në objektin e ri të SHFMU "LIRIA" në Fortesë, është bërë pajisja me inventar shkollor, që përfshin: banka, karriga, dollapa. Ky investim u përkrah nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në objektin e SHML "12 Maji" në Ratkoc, kanë filluar punimet e masave të eficiencës së energjisë elektrike.


Punimet përfshijnë: riparimin e kulmit, ndërrimi i dyerve dhe dritareve, instalimi i ndriçimit të brendshëm efficient, izolimi i jashtëm i objektit dhe veprime tjera të nevojshme.



Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal, ka nënshkruar kontratat me komunën me 10 të rinj të komunës sonë, si përfitues nga skema e granteve që bashkëfinancohet nga komuna me 15% dhe (MAPL) me 85%. Shuma e përgjithshme që të rinjtë përfitojnë nga kjo skemë, është 118.497 dollarë amerikanë. Ky projekt është donacion nga Qeveria Japoneze, i përkrahur nga Banka Botërore.

Në objektin e shkollës "Skender Kastrati", paralela e ndarë në Gexhë, kanë filluar punimet në projektin e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë elektrike. Punimet kanë filluar me riparimin e kulmite më pas me veprime tjera.





Në kuadër të aktivitetit "Ditët e Mërgatës" është organizuar mbrëmje festive, ku grupi i radhës që performoi ishte Jericho, i cili me muzikën e tij ka argëtuar të pranishmit.

Në cilësinë e kryetarit të komunës së Rahovecit e në prani të ambasadorit të SHBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit me USAID për projektin: "Integriteti i Komunave në Kosovë", ku në mesin e tetë komunave të tjera është edhe Komuna e Rahovecit.

Projekti përfshin: mbikëqyrjen e financave publike, sundimin e ligjit, transparencën, llogaridhiënien, eficiencën, efektshmérinë, reagueshmérinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces si dhe menaxhimin e kontratave të prokurimit.



Kryetari Latifi së bashku me z. Visar Hasi, U.D i KRU "Gjakova", ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit për rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit në fshatrat Ratkoc, Bratotin dhe Vrajakë.

Vlera e projektit është 61,000.00 €, nga të cilat Komuna e Rahovecit do të financojë 49% të mjeteve, ndërkaq KRU "Gjakova" 51%.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të aktivitetit “Ditët e Mërgatës”, në Drenoc ka organizuar “Sofrën e Mergimtarit”, ku morën pjesë bashkatdhatarët nga vende të ndryshme.



Së bashku me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi, kryetari Smajl Latifi ka nënshkruar marrëveshjen përmes financiare të projektit “Trajtimi i Vlerave të Trashëgimisë Kulturore dhe Krijimi i Sigurisë së Lëvizjes në Qytetin e Rahovecit”, projekti që kap vlerën prej 174.519.05 €, nga të cilat ministria do të merr pjesë në finansim me 100.000 €, ndërsa Komuna e Rahovecit me 74.519.05 €.

Në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur mbledhja e rregulit e kuvendit, ku në rend dite ishin këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.
3. Shqyrtimi i Raportit finanziar janar – qershor – 2022.
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021/2022.
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021.



PËRFUNDIM

Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit korrik 2022.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendor është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini muJOR ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, korrik 2022